

VENDIM
Nr. 52, datë 5.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE
NR. 34, DATË 13.7.2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 34, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi i përfituar nga diferenca midis vlerës së projektit, miratuar sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, për projektet në vazhdim, i shtohet portofolit të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, për vitin 2016, dhe përdoret për financimin e projekteve të reja të thirrjes së radhës dhe/ose financimin e projekteve në vazhdim.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2015-2016, me reduktim financimi për vitin 2016, dhe saktësim të vlerës së mbetur të financimit për vitin 2017, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla II.

Tabela 1, e vendimit nr.34, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, zëvendësohet me tabelën si më poshtë vijon:

Nr	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera e “kursyer” pas lidhjes së kontratës (në Lekë)	Vlera e financimit e alokuar deri në vitin 2016 (e reduktuar) (Lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017 (Lekë)
Qarku Gjirokastrë							
1	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i “Blv. 18 Shtatori dhe degëzimeve rr. “Rrexhep Qosja” dhe “Gole Gushi”	258 890 879	214 555 424	44 335 455	121 354 708	93 200 716
Qarku Korçë							
2	Bashkia Korçë	Ndërtimi i kompleksit multifunksional, sportiv dhe kulturor	565 897 319	539 886 728	26 010 591	336 163 693	203 723 035
3	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i rrugës Voskopojë, Lekas Loti I	35 267 639	21 153 705	14 113 934	21 153 705	0
			860 055 837	775 595 857	84 459 980	478 672 106	296 923 751

Shënim:

1. “Vlera e projektit”, është vlera e kërkuar në aplikim nga autoriteti kontraktues, për t’u alokuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për zbatimin e projektit dhe e miratuar nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo vlerë korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfituar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, dhe shpëmdahet, për financimin e projekteve të reja dhe/ose në vazhdim. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
2. “Vlera e kontratës”, përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
3. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës”, përfaqëson vlerën e përfituar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës. Fondi i krijuar nga kjo diferencë i shtohet fondit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, dhe shpëmdahet për financimin e projekteve të reja në thirrjen e rradhës dhe/ose në vazhdim të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.
4. “Vlera e financimit e alokuar deri në vitin 2016 (e reduktuar)”, tregon totalin e financimit të dhënë për vitet 2015 dhe 2016, dhe reflekton zbritjen e vlerës së kursyer, pas lidhjes së kontratës.
5. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit të alokuar në vitin 2016 (e reduktuar).